**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

Bartet

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 05/2931/Do-1520
Data / Datum / Date: 22-12-2016
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR / ZA / TO** | **Z. Memli Krasniqi<br>Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural** | **DATË<br>DATUM<br>DATE** | **20.12.2016** |
| | | **Reference** | |
| **NGA / OD / FROM** | **Salih Salihu<br>Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!** | | |
| **SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT** | **Pyetje për përgjigje me gojë** | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja**

Kohëve të fundit në media por edhe në Komisionin parlamentar për bujqësi, janë ankuar farmeret të cilët po kultivojnë mjedrën se materiali fidanor i importuar ka qenë i infektuar me kancer të bimëve. Agjensioni i ushqimit dhe veterinës ka dështuar në kontrollin e këtyre bimëve duke lejuar hyrjen 450 mijë fidane të importuar nga një kompani kosovare e që u janë shitur kultivuesëve të mjedrës duke u shkaktuar këtyre dëme të konsiderueshme materiale.

**Pyetja Parlamentare**

Zoti ministër meqë dëmet materiale të farmerëve janë të mëdha çka keni ndërmarrë apo çka do të ndërmerrni që këta farmerë në të mos dorëzohet por të vazhdojnë vazhdojnë me projektin e tyre për të kultivuar mjedrën?

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përndjekje - Kancelarija za Predloge i Praćenje - Table Office
Nr. Prot. 05/2432/Do-1501
Data 22-12-2016
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

baytet

| PËR / ZA / TO | Z. Memli Krasniqi<br>Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | DATË<br>DATUM<br>DATE | 20.12.2016 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Salih Salihu<br>Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja**

Ky vit ka qenë njeri ndër vitet më të vështira për farmerët kosovarë. Çmimet e ulëta të drithërave (Grurit dhe Misrit) por edhe produkteve tjera bujqësore me origjinë bimore dhe shtazore po e shkatërrojnë prodhimin vendor, duke rrezikuar që sipërfaqet bujqësore të mbesin djerrina në pamundësi për t'i përballuar importit. Pra duke pasur parasysh koston e lartë të prodhimit bujqësor në Kosovë dhe importin e pakontrolluar të produkteve bujqësore, bujqësia si degë e ekonomisë rrezikon të shkatërrohet tërësisht duke e dëmtuar kështu ekonominë e vendit tonë.

**Pyetja Parlamentare**

Zoti ministër, a jeni në dijeni për këtë gjendje të rëndë në sektorin e drithërave dhe nëse po çka jeni duke ndërmarrë që kjo gjendje të përmirësohet?

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

| PËR/ZA/TO | z. Skënder Hyseni<br>Ministër i Punëve të Brendshme | DATË<br>DATUM<br>DATE | 27.12.2016 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA/OD/FROM | Aida Dërguti<br>Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**ÇËSHTJA:** Nga mbledhja e parë e përbashkët midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, në 11 janar 2014 dhe marrëveshjeve të dakorduara, qeveria në Tiranë mori vendim me datë 7 maj 2014 për *Përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare.*

Në mars 2015, pra 1 vit më vonë Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale njoftonte se u firmosën tri marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë. Nënshkrimi u bë në atë kohë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj dhe homologu i tij Arban Abrashi. "Më konkretisht u arrit marrëveshja për heqjen e lejeve të punës dhe liberalizimin e tregut të punës mes dy vendeve, nga Gjirokastra deri në Mitrovicë".

Shqipëria i ka hequr lejet e punës për shtetasit nga Kosova, ndërsa Kosova u zotua ta bëjë këtë shumë shpejt për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Në pyetjen e shtruar Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në seancën e kaluar ai u përgjigj se për këtë duhet të pyesim Ministrin e Punëve të Brendshme dhe se Ministria që drejton ka lobuar për këtë ndryshim si dhe e ka kryer punën por Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk e ka realizuar pjesën e saj.

Tani jemi 2 vite e 5 muaj nga mbledhja e dy qeverive dhe 1 vit e gjysmë nga nënshkrimi i marrëveshjes për lejet e punës.

**PYETJA PARLAMENTARE:** Z. Ministër pse nuk po e zbatoni marrëveshjen e nënshkruar nga Kryeministri dhe Ministrat e Republikës së Shqipërisë me homologët e tyre në Qeverinë e Kosovës, duke mos i hequr ende lejet e punës për shtetasit e Shqipërisë dhe shqiptarët që jetojnë në shtete të tjera të rajonit ?

bartet.

Nr. Prot. 05/3043/Do-1537
Datë: 16.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR/ZA/TO** | **Z. Isa Mustafa, Kryeministër i Republikës së Kosovës** | **DATË DATUM DATE** | **16.1.2017** |
| | | **Reference** | |
| **NGA/OD/FROM** | **Abdyl Ymeri, deputet GP PDK** | | |
| **SUBJEKTI PREDMET SUBJECT** | **Pyetje për përgjigje me gojë** | | |

Në bazë të nenit 45.2 të Rregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, bëjë pyetje më gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës, si vijon:

**Çështja:** Zoti Kryeministër ne jemi dëshmitar të problemit të demarkacionit tash e dy vite, i krijuar nga të gjithë, pavarsisht pozitë-opozitë, por që është problem faktik, që po përdorët edhe për arsye të tjera të njohura dhe në këtë frymë inicitivat e nisura nga Ju, së fundi si iniciativë e radhës, kam informacione së në këtë "Komision" Ju nuk keni ftuar ekspert nga Fakulteti i Ndërtimatarisë – Katedra e Gjeodozisë dhe Kadastrit, e cila është kompetentja kryesore për çështje kadastrale dhe gjeodozike.

**Pyetja:** A është ftuar ndonjë ekspert nga Katedra e Gjeodozisë dhe Kadastrit në Komision për Matjen e Territorit të Kosovës për problemin e Demarkacionit?

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR/ZA/TO | Z. Arban Abrashi<br>Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale | DATË<br>DATUM<br>DATE | 17.01.2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA/OD/FROM | Rexhep Selimi<br>Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja**

Z. Ministër. Me Nenin 8. paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-054 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE. INVALIDËVE. VETERANËVE, PJESËTARËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE është e përcaktuar qartë se të drejtat në benificione si pension familjar dhe beneficione të tjera të përcaktuara me këtë ligj. pra po citoj: "Këto të drejta i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit. të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha te ndryshme historike."

**Pyetja Parlamentare**

Pyetja ime Ministër është: A janë duke gëzuar këtë të drejtë që u'a ka garantuar ky Ligj familjeve të dëshmorëve të kombit që kanë rënë para vitit 1998?

bartet.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

05/3047/Do-1541
17.01.2017

| | | | |
|---|---|---|---|
| PËR / ZA / TO | Z. Imet Rrahmani<br>Ministër i Shëndetësisë | DATË<br>DATUM<br>DATE | 17.01.2017 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Besa Baftiu<br>Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**ÇËSHTJA:**

Z. ministër pyetja ime ka të bëjë me kardiologjinë invazive, siç e dimë Kuvendi i Kosovës ka miratuar marrëveshjen me Unicredit Bank Austria kredinë prej 2.6 milionë euro për funksionalizimin e kardiologjisë invaziv.

Duke e parë se ka pasur shumë paqartësi rreth aneks kontratës prej 500 mijë euro komisioni i shëndetësisë është bërë pjesë e monitorimit të implementimin të këtij projekti. Mirëpo në si komision kemi qenë prezent vetëm me një takim rreth kësaj çështje dhe nuk jemi të informuar më tutje.

Në bazë të marrëveshjes kardiologjia invazive do të duhej te ishte funksionale deri në fund të shkurtit.

**PYETJA PARLAMENTARE:**

Ministër deri ku ka shkuar procesi në këtë drejtim dhe a do të jetë funksionale kardiologjia invazive ashtu siç është paraparë me këtë marrëveshje.

bastet.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Nr. Prot. 05/3048/Do-1542
Datum 17-01-2017

| | | | |
|---|---|---|---|
| PËR / ZA / TO | Z. Imet Rrahmani<br>Ministër i Shëndetësisë | DATË<br>DATUM<br>DATE | 17.01.2017 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Besa Baftiu<br>Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**ÇËSHTJA**

Pyetja ka të bëjë çertifikata mjekësore të cilat janë të obligueshme dhe kërkohen për patentë shoferë si dhe per çështje tjera, problemi qëndron në atë se që një kohë të gjatë është bërë nderprerja e dhënies së çertifikatave mjekësore nëpër QKMF.

Sipas statistikave të hyrat e QKMF-ve nëpër Kosovë kanë rënë me 3-4 fish pasi që tani këto çertifikata lëshohen ekskluzivisht nëpër institucionet shëndetësore private.

**PYETJA PARLAMENTARE**

A do të ndermerrni diç në këtë drejtim në mënyrë që çertifikatat mjekësore për patentë shofer të lëshohen edhe nga institucionet publike shëndetësore.

bartet.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime - Kancelarija za Predloge - Proposals Table Office
Nr. 05/3049 Do-1543
Date 17.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|---|---|---|---|
| PËR/ZA/TO | Z. Ferat Shala<br>Ministër i Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, Ferat Shala | DATË<br>DATUM<br>DATE | 17.01.2017 |
| | | Reference | |
| NGA/OD/FROM | Driton Çaushi<br>Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:**

Z. Ministër,

Gjatë muajve të fundit, qytetarët e Republikës së Kosovës janë alarmuar nga niveli i ndotjes së ajrit në vend, dhe sidomos në kryeqytet.
Matjet e cilësisë së ajrit të realizuara nga Komuna e Prishtinës që nga Janari i vitit 2016 dhe nga monitorimi i fundit i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Mbrojtjen e Mjedisit përmes *"Indeksit të cilësisë së ajrit."* dëshmojnë për seriozitetin e situatës me të cilën po përballën qytetarët dhe shëndeti i tyre.
Në bazë të këtij indeksi, Kosova, gjegjësisht Prishtina, klasifikohet në kategorinë e tretë të ndotjes së ajrit, saktësisht në parametrat 151 deri në 200, me vlerën **157 të PM2.5**, që paraqet nivelin e cilësisë së ajrit si të *pashëndetshme*, ku si shpjegim i kategorisë citohet: *"Të gjithë mund të fillojnë të përjetojnë disa efekte negative shëndetësore, dhe anëtarët e grupeve të ndjeshme mund të përjetojnë efekte më të rënda."*

**Pyetja Parlamentare**

Kanë kaluar muaj të tërë qysh kur media të ndryshme alarmojnë opinionin për nivelin alarmant të ndotjes së ajrit në vend.
Në Kryeqytet qytetarët kanë protestuar në lidhje me këtë qështje.
Nga të dhënat e përditshme që vijnë nga monitorimi i cilësisë së ajrit, Prishtina kualifikohet ndër qytetet më të ndotura në botë.
Cilët janë hapat konkret që ministria juaj ka ndërmarrë për t'iu përgjigjur kësaj gjendje emergjente dhe këtij rreziku serioz shëndetësor me të cilin po përballën qytetarët?